



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА  
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

ОПШТИНА БОГОВИЊЕ  
KOMUNA E BOGOVINËS

РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА-REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT  
Општина Боговиње - Komuna e Bogovinës  
Бр.-Nr. 08-2881/1  
19.11. 2025 год./viti  
Боговиње-Bogovinë

Në bazë të nenit 50 paragrafi 1 pika 16 nga Ligji për vetëqeverisje lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 05/2002 dhe nr. 202/2024) dhe dispozitat nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 12/2019), Kryetari i Komunës së Bogovinës sjell

## RREGULLORE

për menaxhimin me konfliktin e interesave dhe paraqitjen e angazhimit shtesë të nëpunësve në Komunën e Bogovinës.

## Dispozita të përgjithshme

### Neni 1

Me këtë rregullore rregullohet menaxhimi me konfliktin e interesave në Komunën e Bogovinës dhe mënyra e paraqitjes së angazhimit shtesë të nëpunësve të komunës. Rregullorja përcakton konfliktin e interesave, llojet e konfliktit të interesave, masat parandaluese dhe aktivitetet tjera për parandalimin e paraqitjes së tij në komunë. Kjo rregullore zbatohet për: kryetarin e komunës, këshilltarët e Këshillit të Komunës, personat e emëruar prej tyre dhe të punësuarit në administratën komunale.

## Konflikti i interesave, llojet dhe masat parandaluese

### Neni 2

Me "konflikt interesi" nënkuptohet gjendja kur një nëpunës publik ka interes privat që ndikon ose mund të ndikojë në ushtrimin e paanshëm të autorizimeve publike ose të detyrave zyrtare të tij.

Konflikti i interesave ka të bëjë me situata në të cilat paanshmëria dhe objektiviteti i vendimit, mendimit ose rekomandimit të nëpunësit publik mund të komprometohen nga interesi i tij privat.

- Me termin "nëpunës publik" nënkuptohen të gjithë personat e zgjedhur ose të emëruar dhe të punësuarit në sektorin publik.

- “Autorizim publik” do të thotë kompetencë e deleguar nga shteti ose vetëqeverisja lokale për ushtrimin e punëve me interes publik.
- “Detyrë zyrtare” nënkupton detyrimet që dalin nga ushtrimi i një funksioni, profesioni ose pozite zyrtare.
- “Interes privat” është çdo përfitim material ose jomaterial, privilegj apo avantazh për vete ose për person tjetër gjatë ushtrimit të funksioneve publike.
- “Integritet” nënkupton ushtrimin ligjor, profesional, të pavarur, etik dhe transparent të detyrave me të cilat ruhet reputacioni personal dhe institucional, eliminohen rreziqet dhe dyshimet për korrupsion ose konflikt interesi, duke siguruar besimin e qytetarëve në institucionet publike.
- “Familje” nënkupton bashkëshortin/en, partnerin jashtëmartesë, fëmijët, prindërit, vëllezërit dhe motrat dhe të afërmit e tjerë që jetojnë në të njëjtin ekonomi familjare.
- “Persona të afërt” janë personat në lidhje martesore ose jashtëmartesore me nëpunësin publik, të afërmit deri në shkallën e katërt të gjakut dhe deri në shkallën e dytë të krushqisë, si dhe çdo person fizik ose juridik me të cilin nëpunësi publik ka interes financiar.

### Neni 3

Sipas Politikës për integritet të Komunës së Bogovinës, kryetari i komunës, anëtarët e këshillit dhe të punësuarit në administratën komunale janë të detyruar të respektojnë parimet e ligjshmërisë, barazisë dhe transparencës, normat etike dhe standardet profesionale, pa diskriminim apo privilegjim të çfarëdo lloji, duke vepruar gjithmonë në përputhje me interesin publik. Në ushtrimin e funksioneve, ata duhet të shmangin çdo situatë të konfliktit të interesave dhe të mos udhëhiqen nga interesa personale, familjare, fetare, partiake ose etnike, apo nga presione ose premtime nga eprorë apo persona të tjerë. Askush nuk mund të shfrytëzojë funksionin publik për veprim ose mosveprim që është në kundërshtim me ligjin, dhe nuk mund ta nënshtrojë ushtrimin e detyrës ligjore ndaj interesit personal ose të ndonjë personi tjetër.

## Llojet e konfliktit të interesave

### Neni 4

Konflikti i interesave mund të paraqitet në tri forma: **real (faktik)**, **i dukshëm (i supozuar)** dhe **potencial**.

- Konflikti **real** i interesave paraqet përplasje të drejtpërdrejtë ndërmjet autorizimeve publike dhe detyrave zyrtare të nëpunësit dhe interesit të tij privat.
- Konflikti **i dukshëm** i interesave është situata që mund të perceptohet nga persona të tjerë si e tillë që interesat private të nëpunësit publik mund të ndikojnë në mënyrë të papërshtatshme në ushtrimin e detyrës zyrtare. Edhe nëse ndikim real nuk ekziston,



perceptimi i mungesës së paanshmërisë mund të mjaftojë për ta konsideruar konflikt të dukshëm.

- Konflikti **potencial** i interesave është situata kur nëpunësi publik ka interes privat që në të ardhmen mund ta çojë në pozitë të konfliktit të interesave gjatë ushtrimit të funksionit apo autorizimeve publike.

## Ndalesat dhe kufizimet për nëpunësit publikë për parandalimin e konfliktit të interesave

### Neni 5

Nëpunësi publik nuk guxon të ndikojë në punësimin ose avancimin e një personi të afërt në organin ku është zgjedhur apo emëruar si funksionar publik, ose në ndonjë organ tjetër shtetëror, ndërmarrje publike, institucion publik apo person juridik që menaxhon me kapital shtetëror nën mbikëqyrjen e atij organi.

### Neni 6

Sipas nenit 44 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave, personi i zgjedhur ose i emëruar gjatë ushtrimit të mandatit të tij është i detyruar të respektojë rregullat për **papajtueshmëri** **të** **funksioneve**. Personi i zgjedhur ose i emëruar nuk mund njëkohësisht të kryejë funksion të personit përgjegjës apo anëtarit të organit drejtues ose mbikëqyrës në ndërmarrje publike, institucion publik apo person juridik që menaxhon me kapital shtetëror. Gjithashtu, nuk mund të jetë anëtar i bordit drejtues apo organit tjetër të menaxhimit në shoqëri tregtare ose person juridik që ushtron veprimtari fitimprurëse. Nëpunësit e administratës lokale që zgjidhen si anëtarë të këshillit komunal u pezullohet marrëdhënia e punës, sipas ligjit, nga dita e verifikimit të mandatit të këshilltarit.

### Neni 7

Personi që merr funksion të zgjedhur ose të emëruar, me përjashtim të atyre që kryejnë funksione jo profesionale, nëse është pronar ose udhëheqës i një shoqërie tregtare apo institucioni, është i detyruar që **menaxhimin t'ia besojë një personi tjetër**, përveç anëtarëve të familjes, gjatë kohës së ushtrimit të funksionit publik. Çdo person i zgjedhur ose i emëruar, person përgjegjës në ndërmarrje publike, institucion publik apo person juridik me kapital shtetëror, është i detyruar **brenda 30 ditëve nga dita e marrjes së funksionit** t'i paraqesë organit përkatës të dhënat për personat juridikë në pronësi të tij, aksionet, pjesëmarrjet apo funksionet drejtuese që zotëron. Organet përkatëse janë të detyruara t'i publikojnë këto të dhëna.

## Neni 8

Nëpunësi publik gjatë ushtrimit të funksionit të tij nuk mund të krijojë marrëdhënie afariste me persona juridikë që janë në pronësi të tij ose të anëtarëve të familjes, ose ku ai apo familjarët e tij zotërojnë aksione, pjesëmarrje apo pozita drejtuese.

## Neni 9

Nëpunësi publik nuk guxon të ushtrojë ndikim të paligjshëm në procedurat e **prokurimit publik**. Kjo dispozitë vlen edhe për procedurat që zhvillohen me konkurs publik, shpallje ose ankand për dhënie lelesh, koncesionesh apo autorizimesh për ushtrimin e veprimtarive ekonomike.

## Neni 10

Nëpunësi publik nuk mund të përdorë informacione që i ka në dispozicion gjatë ushtrimit të funksionit për të siguruar përfitim ose avantazh për vete apo për të tjerët. Ai nuk guxon të fshehë të dhëna që me ligj duhet të publikohen, as të kërkojë qasje në të dhëna për të cilat nuk është i autorizuar.

## Neni 11

Personi juridik që ka për themelues ose pronar një person të zgjedhur apo të emëruar, ose anëtar të familjes së tij, nuk mund të jetë përfitues i **grantit, huasë apo mbështetjes financiare** nga shteti apo nga njësia e vetëqeverisjes lokale.

# Veprimi në rast të ekzistimit të konfliktit të interesave

## Neni 12

Nëpunësi publik është i detyruar të vëzhgojë dhe të identifikojë çdo konflikt të mundshëm të interesave dhe të ndërmarrë masa për shmangien e tij.

## Neni 13

Në rast dyshimi për ekzistimin e konfliktit të interesave, nëpunësi publik është i detyruar të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për të shmangur ndikimin e interesit privat të tij apo të personave të tjerë në ushtrimin e detyrave zyrtare dhe ta njoftojë menjëherë eprorin e tij.

## Neni 14



Në rast të ekzistimit të dyshimit për konflikt interesi, nëpunësi publik është i detyruar të kërkojë mendim nga **Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit**.

---

## **Paraqitja e konfliktit të interesave dhe përjashtimi nga vendimmarrja**

### **Neni 15**

Nëse nëpunësi publik merr pjesë në mbledhje ose diskutim të organit ku vendoset për çështje në të cilat ai ose person i afërt ka interes privat, është i detyruar ta deklarojë këtë interes dhe të përjashtohet nga diskutimi dhe vendimmarrja **para fillimit të procedurës së vendimit**. Organet përkatëse duhet ta evidentojnë këtë fakt në procesverbal. Mosdeklarimi i interesit privat përbën **shkelje të detyrës zyrtare** dhe bazë për fillimin e procedurës disiplinore.

### **Neni 16**

Sipas nenit 44 të Ligjit për vetëqeverisje lokale, anëtari i këshillit nuk mund të marrë pjesë në vendimmarrje për çështje ku ai, bashkëshorti/ja, fëmijët apo të afërmit deri në shkallën e dytë kanë interes financiar ose personal. Ai është i detyruar ta informojë këshillin për çdo rast të tillë. Anëtari i këshillit nuk mund të jetë i punësuar në administratën komunale të komunës ku është zgjedhur. Me ditën e punësimit, konsiderohet se ka dhënë dorëheqje nga mandati i këshilltarit. Nëse është i punësuar në ndonjë institucion publik të themeluar nga komuna, nuk mund të marrë pjesë në vendimmarrje për çështje që kanë të bëjnë me atë institucion.

### **Neni 17**

Nëpunësi publik që merr pjesë në procedura për zgjedhje, emërimi apo punësimi është i detyruar ta njoftojë personin përgjegjës të institucionit për çdo situatë që mund të shkaktojë konflikt interesi. Në rast dyshimi, si nëpunësi ashtu edhe eprori mund të kërkojnë mendim nga Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit.

### **Neni 18**

Kur nëpunësi publik mëson për rrethana që tregojnë për ekzistimin e një konflikti aktual ose potencial të interesave, ai duhet menjëherë të kërkojë **përjashtim** nga procedura. Përjashtimi bëhet me vendim të organit ku ai ushtron funksionin, me kërkesë të tij ose të ndonjë personi të interesuar.

## Neni 19

Kryetari i komunës me vendim cakton **personin për integritet** – kontakt person për këshilla dhe konsultime në lidhje me konfliktin e interesave. Çdo konflikt faktik, potencial apo i dukshëm mund të paraqitet tek ky person. Personi për integritet harton **plan vjetor trajnimi** për identifikimin dhe trajtimin e rasteve të konfliktit të interesave, në bashkëpunim me udhëheqësinë komunale.

## Paraqitja e angazhimit shtesë

### Neni 20

Sipas nenit 44 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave, nëpunësi publik mund të realizojë të ardhura nga veprimtari shkencore, arsimore, kulturore, artistike dhe sportive, si dhe nga të drejtat autoriale, patentat dhe pronësia intelektuale ose industriale, përveç kur ligji parashikon ndryshe.

### Neni 21

Nëse nëpunësi publik, krahas detyrës zyrtare, merr ofertë për angazhim nga ndonjë institucion tjetër, kompani ose projekt me interes publik, ai është i detyruar ta paraqesë me **kërkesë me shkrim për angazhim shtesë** tek personi për integritet në Komunën e Bogovinës. Ky person e vlerëson nëse ekziston **konflikt potencial interesi** dhe e informon eprorin më të lartë, i cili vendos për miratimin e angazhimit. Në rast nevojë, mund të kërkohet mendim nga Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit.

### Neni 22

Nëse kërkesa për angazhim shtesë miratohet, nëpunësi publik është i detyruar të nënshkruajë **deklaratë për mos ekzistimin e konfliktit të interesave** dhe për **ruajtjen e konfidencialitetit të të dhënave**, për mbrojtjen e interesave të Komunës së Bogovinës dhe të interesit publik.

### Neni 23

Personi i zgjedhur ose i emëruar, personi përgjegjës në ndërmarrje publike, institucion publik apo person juridik që menaxhon me kapital shtetëror, si dhe nëpunësi administrativ nga kategoria A, është i detyruar që **brenda 3 ditëve nga dita e emërimit ose punësimit** të dorëzojë **deklaratë për gjendjen pasurore dhe interesat personale**. Ai është i detyruar të dorëzojë deklaratë të re edhe **brenda 30 ditëve nga dita e ndërprerjes së**

### **funksionit.**

Deklaratat dorëzohen tek Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit. Çdo rritje e pasurisë mbi vlerën e njëzet pagave neto mesatare ose çdo ndryshim i interesave duhet të deklarohet brenda 30 ditëve.

## **Dispozita kalimtare dhe përfundimtare**

### **Neni 24**

Marrja e masave parandaluese dhe aktiviteteve për parandalimin e konfliktit të interesave është e rregulluar me:

- Ligjin për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave,
  - Ligjin për vetëqeverisje lokale,
  - Ligjin për të punësuarit në sektorin publik,
  - Ligjin për nëpunësit administrativë,
  - Ligjin për prokurimet publike,
- dhe akte të tjera pozitive ligjore.

Standardet etike dhe rregullat e sjelljes së nëpunësve administrativë përcaktohen me

**Kodin e nëpunësve administrativë** ("Gazeta Zyrtare e RM" nr.183/2014).

Gjatë punësimit, nëpunësi administrativ nënshkruan **Deklaratën për misionin e përbashkët të të punësuarve në sektorin publik.**

### **Neni 25**

Kjo rregullore hyn në fuqi me ditën e miratimit dhe publikohet në faqen zyrtare të Komunës së Bogovinës.

**Komuna e Bogovinës**

**Kryetar**

**Feti Abazi**

